

Vendim nr. 12 datë 24.01.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Anëtare

Fiona Papajorgji, Anëtare

Illir Toska, Anëtar

në datën 24.01.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17 (S) 2022 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SONILA MUHAMETAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2022-1717 (265), datë 07.07.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 101 (31157-00020-86-2022) të regjistrit themeltar, datë 20.06.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 385, datë 13.12.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Mbi miratimin e shkallës së vlerësimit të kandidatëve për ngritjen në detyrë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”; nr. 386, datë 13.12.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Mbi miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”; nr. 387, datë 13.12.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për emërimin si prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të kandidatit E.G.”; nr. 388, datë 13.12.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për emërimin si prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të kandidatit A.Sh.”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Lënia në fuqi e vendimit nr. 36, datë 24.05.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 17, 18, 42, 43, 116, 118, 124, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 148 e vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja gëzon statusin e magjistratit. Ajo është emëruar prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me dekretin nr. 5053, datë 04.10.2006 të Presidentit të Republikës. Prej datës 07.12.2021, me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (*KLP*), ajo ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Me vendimin nr. 319, datë 04.10.2021, KLP-ja ka filluar procedurat për ngritjen në detyrë nga radhët e prokurorëve, për dy pozicione të lira në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*). Në datën 08.10.2021 ajo ka shpallur thirrjen për pjesëmarrje (kandidim) në këto procedura për ngritjen në detyrë, në të cilën kanë kandiduar tre prokurorë, ndër ta edhe kërkuesja.

3. Pas përfundimit të afatit të kandidimit është ngritur Komisioni i Posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme.

4. Me vendimin nr. 356, datë 03.11.2021, me propozim të Komisionit të Posaçëm, KLP-ja ka miratuar listën e kandidatëve që plotësonin kushtet ligjore për ngritjen në detyrë në Prokurorinë e Posaçme.

5. Me vendimin nr. 385, datë 13.12.2021, me propozim të Komisionit të Posaçëm dhe pas intervistimit të kandidatëve, KLP-ja ka miratuar shkallën e vlerësimit të kandidatëve për ngritjen në detyrë në Prokurorinë e Posaçme.

6. Me vendimin nr. 386, datë 13.12.2021, KLP-ja ka miratuar listën e renditjes së kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, për dy pozicionet e lira në proces. Në këtë listë kërkuesja është renditur e treta.

7. Me vendimet nr. 387 dhe nr. 388, datë 13.12.2021, KLP-ja ka emëruar si prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, për një mandat 9-vjeçar pa të drejtë riemërimi, dy kandidatët e renditur më lart.

8. Kërkuesja është njohur me të gjithë dokumentacionin e procedurave për ngritjen në detyrë dhe, duke mos qenë dakord me to, si dhe me vlerësimin e saj si kandidate, ajo, në datën 13.01.2022, ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Apelit kundër KLP-së, përmes së cilës ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të KLP-së nr. 356, datë 03.11.2021, nr. 385, datë 13.12.2021, nr. 386, datë 13.12.2021, nr. 387, datë 13.12.2021 dhe nr. 388, datë 13.12.2021. Njëkohësisht, me padinë e saj, kërkuesja ka kërkuar edhe shfuqizimin e këtyre vendimeve. Në vijim, në funksion të rregullimit të pasojave nga aktet e kundërshtuara, në njëjtën padi kërkuesja ka kërkuar kualifikimin për emërimin e saj në Prokurorinë e Posaçme, si dhe detyrimin e KLP-së për të vijuar me procedurën e emërimit të saj si prokurore në atë prokurori.

9. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 36, datë 24.05.2022, ka vendosur: *“Pranimin e pjesshëm të padisë. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 385, datë 13.12.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Mbi miratimin e shkallës së vlerësimit të kandidatëve për ngritjen në detyrë pranë Prokurorisë së Posaçme”. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 386, datë 13.12.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Mbi miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 387, datë 13.12.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për emërimin si prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 388, datë 13.12.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për emërimin si prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”. Detyrimin e palës së paditur Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të rishikojë procesin e përzgjedhjes të ngritjes në detyrë të kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera, si të pabazuara në ligj.”.* Në dispozitivin e vendimit gjykata është shprehur se ai është përfundimtar dhe i formës së prerë.

10. Në datën 08.06.2022, Avokatura e Shtetit, si përfaqësuese e KLP-së, ka paraqitur rekurs. Gjykata Administrative e Apelit, në dhomë këshillimi, pasi ka verifikuar kushtet formale të pranueshmërisë së rekursit, me vendimin nr. 101 (31157-00020-86-2022) të regjistrit themeltar,

datë 13.06.2022, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Avokatura e Shtetit, kundër vendimit nr. 36, datë 24.05.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit.”*. Në dispozitivin e vendimit gjykata është shprehur se kundër tij lejohet rekurs i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

11. Në datën 17.06.2022, Avokatura e Shtetit, si përfaqësuese e KLP-së, ka paraqitur rekurs të veçantë në Gjykatën e Lartë, me të cilin ka kërkuar prishjen e vendimit nr. 101 (31157-00020-86-2022) të regjistrimit themeltar, datë 13.06.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit *“Për mospranimin e rekursit”* dhe shqyrtimin e rekursit kundër vendimit nr. 36, datë 25.04.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit. Edhe në këtë rast, Gjykata Administrative e Apelit, në dhomë këshillimi, pasi ka verifikuar kushtet formale të pranueshmërisë së rekursit të veçantë, me vendimin nr. 101 (31157-00020-86-2022) të regjistrimit themeltar, datë 20.06.2022, ka vendosur: *“Pranimin e rekursit të veçantë të paraqitur nga Avokatura e Shtetit kundër vendimit nr. 101, datë 13.06.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit “Për mospranimin e rekursit”.*”

12. Në datën 01.07.2022 kërkesja ka paraqitur kundërrekurs si ndaj rekursit të veçantë, ashtu edhe ndaj rekursit të paraqitur nga Avokatura e Shtetit, si përfaqësuese e KLP-së. Me anë të kundërrekursit ajo ka kërkuar mospranimin e rekursit të veçantë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 36, datë 25.04.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi dhe me vendimin nr. 00-2022- 1717 (265), datë 07.07.2022, ka vendosur: *“1. Prishjen e vendimit nr. 101 (31157-00020-86-2022) regj. them., të datës 13.06.2022 “Për mospranimin e rekursit” të Gjykatës Administrative të Apelit. 2. Prishjen e vendimit nr. 36, datë 24.05.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë kësaj gjykate me trup tjetër gjykues.”*

14. Në datën 30.11.2022 kërkesja i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Administrative të Apelit për pranimin e rekursit të veçantë ndaj vendimit të mospranimit të rekursit, të KLP-së për vlerësimin, si dhe renditjen e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Prokurorinë e Posaçme dhe ato për emërimin në atë prokurori të të dy kandidatëve të renditur më lart.

II

Pretendimet e kërkeses

15. Kërkesja, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se aktet objekt ankimi cenojnë:

- 15.1. Të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspektet e mëposhtme:
- 15.1.1. *E drejta për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka planifikuar çështjen për gjykim me shumë urgjencë dhe në shkelje të dispozitave procedurale, me pasojë shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese. Interesi i lartë publik që paraqet funksionaliteti i Prokurorisë së Posaçme, i parashtruar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, nuk përbën arsye ligjore për shqyrtimin e çështjes jo sipas afatit ligjor 90-ditor që përcakton neni 60 i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012).
- 15.1.2. *E drejta për t’u dëgjuar si palë në proces*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve, sipas urdhërimit të nenit 62, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 49/2012, ndonëse kufizimi i së drejtës për rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit paraqet rëndësi nga pikëpamja e njësimin dhe zhvillimit të praktikës gjyqësore (megjithëse e njësuar më parë prej saj), si dhe problematika dhe kompleksiteti i çështjes diktojnë nevojën për thirrjen dhe dëgjimin e palëve. Në këtë mënyrë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka mohuar të drejtën për të qenë e pranishme në gjykim dhe për t’u dëgjuar për argumentet kundër shkaqeve të rekursit, qëndrim ky që duket haptazi edhe në hapësirën e lënë në arsyetimin e vendimit për kundërrekursin, ku nuk shprehet për asnjë nga pretendimet e ngritura në të.
- 15.1.3. *E drejta e aksesit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka zhvilluar asnjë seancë paraprake për shqyrtimin e rekursit të veçantë dhe të rekursit. Ky kolegji ka shqyrtuar vetëm afatin e paraqitjes së rekursit të veçantë, por jo kushtet e tjera ligjore që duhet të plotësojë sipas parashikimeve të neneve 56, shkronja “a”, 57 dhe 58 të ligjit nr. 49/2012, si për sa u përket elementeve të përmbajtjes, ashtu edhe të formës, mangësi këto të evidentuara në kundërrekurs. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka pasur detyrimin të shqyrtonte kushtet e pranueshmërisë së rekursit të veçantë, për sa kohë Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pranimin e tij. Për të njëjtat arsye edhe rekursi nuk plotësonte kushtet formale për t’u pranuar për

shqyrtim, për sa kohë vendimi nr. 36, datë 24.05.2022 i Gjykatës Administrative të Apelit ishte përfundimtar dhe i formës së prerë.

15.1.4. *Standardi i arsytimit të vendimit*, pasi në vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mungon arsyetimi për kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim të rekursit të veçantë dhe të rekursit. Po kështu, argumenti i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka çuar në prishjen e vendimit nr. 36, datë 24.05.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, pra mungesa e shumicës vendimmarrëse, nuk parashikohet nga ligji si shkelje e rëndë procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit. Jurispudenca e së drejtës njeh mendimin konkurrues, paralel ose kundër. Gjykata e Lartë ka keqinterpretuar mendimin paralel të gjyqtarit të gjykatës së apelit që ka formuar shumicën vendimmarrëse.

15.1.5. *E drejta për ankim efektiv*, sipas nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në kundërrekurs.

15.2. Vlerat kushtetuese të shprehura në nenin 3 të Kushtetutës lidhur me dinjitetin, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, drejtësinë shoqërore dhe rendin kushtetues, si bazat e ndërtimit të shtetit, si dhe me detyrimin e shtetit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, të parashikuar në nenin 1 të KEDNJ-së.

15.3. Parimet e ligjshmërisë, shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së normave juridike të shprehura në nenin 4 të Kushtetutës, pasi vendimet e kundërshtuara të KLP-së janë bazuar në rregullore, të cilat bien në kundërshtim me ligjin, nuk respektojnë hierarkinë e akteve normative të parashikuar në nenin 116 të Kushtetutës, dhe as garancinë e nxjerrjes së akteve nënligjore, në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuases

16. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe të nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin

përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

17. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative. Pra, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

18. Kërkuësja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2 të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë.

19. Një kriter tjetër paraprak, që duhet të përmbushet nga ankuesi individual përpara se t’i drejtohet Gjykatës, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

20. Shterimi i mjeteve juridike efektive ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Si rregull, individ mund t’i drejtohet Gjykatës për kontrollin e kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor, i cili ka vendosur në mënyrë përfundimtare për të drejtën kushtetuese që pretendohet të jetë cenuar. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t’i drejtohet asaj duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që ankuesi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr.*

31, datë 25.05.2015; nr. 15, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtijshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

21. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuuesja ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit (për pranueshmërinë e rekursit të veçantë). Sipas kërkueses, në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, asaj i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, së drejtës për t'u dëgjuar si palë në proces, së drejtës së aksesit, standardit të arsyetimit, si dhe së drejtës për ankim efektiv, të garantuara nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës. Po kështu, kërkuuesja ka kërkuar edhe shfuqizimin e disa vendimeve të KLP-së, me pretendimin se ato janë nxjerrë në cenim të disa vlerave dhe parimeve kushtetuese.

22. Në lidhje me këto pretendime, Kolegji konstaton se Gjykata Administrative të Apelit, pasi ka pranuar padinë e kërkueses për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve objekt gjykimi të KLP-së, në vijim ka vendosur mospranimin e rekursit të Avokaturës së Shtetit (si përfaqësuese e KLP-së), duke i njohur palës të drejtën e kundërshtimit të këtij vendimi me anë të rekursit të veçantë. Pala ka ushtruar të drejtën e rekursit të veçantë, për të cilin kjo gjykatë është shprehur se plotëson kushtet formale të pranueshmërisë, ndërkohë që kërkuuesja ka paraqitur kundërrkurs. Mbi këtë bazë çështja i ka kaluar për shqyrtim Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ i së cilës, me vendimin nr. 00-2022-1717 (265), datë 07.07.2022, pasi ka prishur vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit për mospranimin e rekursit, ka shqyrtuar këtë të fundit, duke vendosur prishjen e vendimit (të themelit) të kësaj gjykate dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë. Në të tilla rrethana, gjykimi i çështjes gjyqësore i iniciuar nga kërkuuesja është ende në proces dhe nuk ka përfunduar.

23. Në raste analoge, Gjykata është shprehur se vendime të këtij lloji nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Me fjalë të tjera, vendime të këtij lloji, për më tepër kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, nuk mund të quhen përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Në të tilla raste kërkuuesja i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të saj gjatë rigjykimit të çështjes, përfshirë më pas

edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr.39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Për sa më lart, Kolegji çmon se vendimi objekt i ankimit kushtetues individual nuk ka vendosur në mënyrë përfundimtare për çështjen gjyqësore, prandaj kërkesja nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

25. Në përfundim të analizës për kriteret paraprake, Kolegji vlerëson se çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.